



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 361 Prot.

Tiranë, më datë 23.08.2024

VENDIM
Nr. 316, datë 23.08.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 23.08.2024:

VENDOSI:

- Miratimin e projektit “Rikualifikim urban në fshatin Theth”, Brenda Kufirit Qendër Historike Theth, me aplikues ‘Son Engineering Construction’ dhe zhvillues **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**, me rekomandimet e mëposhtme:
 - Të sigurohet një konturim i shtigjeve që parashikohet të shtrohen me çakëll duke realizuar një sistemim anësor me gjelbërim;
 - Parapetet e urës dhe të gardheve të mos kalojnë lartësinë 1.5 metra në mënyrë që të lejohet fushëpamja e natyrës;
 - Në fazën pasardhëse të parashikohet mbulimi i objekteve në mënyrë të unifikuar me çati;
 - Sistemi i brigjeve të lumit të realizohet me blloqe masive natyrore, aty ku është e mundur;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI



KRYETAR
Blendi GONXHJA